

Formular për SYLLABUS per Financat Personale

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës		
Titulli i lëndës:	Financat personale		
Niveli:	Bachelor		
Statusi lëndës:	Zgjedhore		
Viti i studimeve:	Semestri III (viti II-të)		
Numri i orëve në javë:	2+1		
Vlera në kredi – ECTS:	4 ECTS		
Koha / lokacioni:			
Mësimdhënësi i lëndës:	Ass.Dr.Sc. Arber Hoti, AC, CertIFR, CertIA		
Detajet kontaktuese:	arber.hoti@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës			
	Ky kurs integron konceptet e ekonomisë dhe të financave personale për të ndihmuar studentët të kuptojnë më mirë implikimet e ngjarjeve ekonomike dhe të marrin vendime financiare të informuara. Financat personale siguron mjetet e nevojshme për studentët që të fitojnë shkathhtësi ekonomike dhe financiare. Kursi gjithashtu ofron një sërë aplikacionesh praktike për të ndihmuar studentët të kuptojnë kompleksitetin e vendimmarrjes financiare.		
Qëllimet e lëndës:			
	Ky kurs ka për qëllim të nxisë një shkallë të pavarësisë financiare dhe besueshmëri mbi tema të tilla si buxhetimi, planifikimi i karrierës, pagesa e taksave, arritja dhe përdorimi pozitiv i kredisë, mundësitë për investime dhe sigurimi.		
Rezultatet e pritura të nxënies:			
	Studentët që përfundojnë kursin do të jenë në gjendje të llogarisin vlerën monetare të arsimit shtesë, të vlerësojnë projektet e ardhshme të biznesit, të investojnë dhe të vlerësojnë letrat me vlerë financiare dhe të planifikojnë për të ardhmen e tyre.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiime, seminare	1	2	2

Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgatitja përfundimtare për provim	1	1	1
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	2	2
Projektet, prezantimet, etj	1	15	15
Totali			100
Metodologjia e mësimdhënies:			
	<p>Përcjellja e rregullt e ligjëratave dhe ushtrimeve është esenciale. Studentët të cilët janë të rregullt kanë sukses ndërsa ata të cilët nuk shkojnë rregullisht në orë kanë probleme.</p> <p>Leximi i rregullt i kapitujve të përcaktuar më parë. Mësimi i kësaj lënde është i vazhdueshëm, kuptimi i koncepteve të reja është ngushtë i lidhur me mësimin e koncepteve nga kapitujt paraprak.</p> <p>Mundohuni të zhvilloni kuptimin e koncepteve. Mos tentoni të mbani në mend materialet. Në të shumtën e rasteve mbajtja mend nuk do të ndihmojë në studimin tuaj. Në këtë lëndë detyrat në të shumtën e rasteve kërkojnë të aplikoni konceptet e mbuluara më herët dhe të mendoni për materialet e prezantuara më herët. Këto detyra nuk mund të kryhen pa i trajtuar në esencë problemet dhe pa menduar mirë. Kjo na jep të kuptojmë se nuk duhet të ngutemi në fillimin e kryerjes së detyrës në formën teknike për detyra të caktuara. Duhet të kaloni pak kohë duke konsideruar mësimet e mbuluara në klasë dhe kërkesat lidhur me detyrat specifike.</p>		
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi i studentëve: pjesëmarrja aktive në ligjertata dhe ushtrime (20%) kollokfiime (40%) dhe provimi përfundimtar (40%). Kriteret e kalimit: 91-100 pikë = nota 10; 81-90 pikë = nota 9; 71-80 pikë = notaa 8; 61-70 pikë = nota 7; 51-60 nota = Klasa 6; nën 50 pikë = nota 5.</p>		
Literatura			
Literatura bazë:	Financat Personale – Botimi i shtatë – Arthur J. Keown, Pearson, Përkthim zyrtar në shqip nga (Brikena Leka dhe Perseta Grabova).		
Literatura shtesë:	Personal Financial Literacy, Pearson Education, Inc./Prentice-Hall Publishing, 2010 ©. Jeff Madura, Mike Casey, Sherry J. Roberts, authors.		
Plani i dizajnuar i mësimet:			
Java	Ligjërata që do të zhvillohet		
<i>Java e parë:</i>	Njohtimi me sillabusin		
<i>Java e dytë:</i>	Porcesi i planifikimit financiar		

<i>Java e tretë:</i>	Matja e shëndetit financiar dhe planifikimi
<i>Java e katërt:</i>	Të kuptuarit e vlerës në kohë të parasë
<i>Java e pestë:</i>	Planifikimi tatimor dhe strategjitë
<i>Java e gjashtë:</i>	Menaxhimi i parasë
<i>Java e shtatë:</i>	Shfrytëzimi i kartave kreditore
<i>Java e tetë:</i>	Testi 1
<i>Java e nëntë:</i>	Kreditë studentore dhe konsumatore: roli i huazimeve
<i>Java e dhjetë:</i>	Vendimarrja për të blerë shtëpi dhe automobil
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Bazat e investimeve
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Investimet në aksione
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Investimet në letrat me vlerë tjera
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Përgatitje për testimin final
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Testi final
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>Vijimi i rregullt i ligjëratave dhe ushtrimeve është i obliguar për të gjithë studentët e rregullt. Të gjithë studentët janë të obliguar që t'i përfillin rregullat e mirësjelljes: mbajtja e qetësisë, ç'kyqja e telefonave celularë dhe hyrja në sallë me kohë.</p>	